



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1042/ 13 prot.

Datë 30.05.2025

V E N D I M

Nr. 725/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.05.2025 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Shërbime” me nr. REF -41187-03-15-2025, me objekt: “Supervizion punimesh për objektin: “Ndërtimi i Ujësjiellësave për fshatrat Fushëbardhe - Zhulat, Bashkia Gjirokastrë”, me fond limit 3,332,777 (tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastrë Sh.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK me NIPT L51825011V dhe adresë Tiranë, Rruga e Kavajës, ish-Parku, pranë "Tregut 100 Vitrinat", Kulla C, Shkalle 2.

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime
Gjirokastrë Sh.A me adresë "Rr.Muharrem
Gega "Nd.24, Hy. 1, Gjirokastrë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4.Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 17.03.2025, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar, Shërbime*” me nr. REF -41187-03-15-2025, me objekt: “*Supervizion punimesh per objektin: “Ndërtimi i Ujësjellësave për fshatrat Fushëbardhe - Zhulat, Bashkia Gjirokastër*”, me fond limit 3,332,777 (tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.A.

II.2. Në datën 02.04.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 16.04.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. Taulant shpk	2,907,120.81	I kualifikuar
2. A&E Engineering shpk	2,925,000	I kualifikuar
3. Bersant Ylli	0	I skualifikuar
4. Firmitas Studio	0	I skualifikuar
5. G B Civil Engineering	2,878,990.19	I skualifikuar
6. BOE HE & SK 11 dhe HTS COMPANY	3,011,241.72	I kualifikuar
7. HYDRO-ENG CONSULTING	2,907,197.5	I kualifikuar
8. Magna Charta	3,011,241.72	I kualifikuar
9. Net-Group	2,905,304.2	I skualifikuar
10. NOVATECH STUDIO	2,885,893.67	I skualifikuar
11. BOE XH & MILER shpk dhe ARENA MK shpk	2,905,749	I kualifikuar
12. ZENIT & CO	2,905,304.2	I skualifikuar

II.4. Në datën 18.04.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraprak, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 20, datë 22.04.2025, ku është shpallur fitues BOE XH & MILER shpk dhe ARENA MK shpk.

II.5. Në datën 22.04.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5260 dhe me nr. 1042/2025 prot., datë 22.04.2025 e operatorit ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GB Civil Engineering” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në

bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1042/1 prot., datë 23.04.2025.

II.7. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse me nr. 575/15 prot, datë 30.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 1042/2 prot., datë 02.05.2025, me objekt: “*Njoftim Komisionit të Prokurimit Publik*”, është përcjellë nga autoriteti kontraktor Vendimi i Komisioni i Shqyrtimit të Ankeave, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “GB Civil Engineering” SHPK, mbi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8 Me shkresën nr. 575/14 prot., datë 30.04.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e KSHA lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “G B Civil Engineering” SHPK. Referuar vendimit të KSHA-së, rezulton se, kjo e fundit **e ka refuzuar**.

II.9. Me shkresën nr. 1042/3 prot., datë 09.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua, autoritetit kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër Sh.A., me kërkesë për informacion të detajuar mbi procesverbalin e përllogaritjes së fondit limit të projektit të zbatimit me objekt “*Ndërtimi i Ujësjiellësave për fshatrat Fushëbardhe - Zhulat, Bashkia Gjirokastër*”, referuar të cilit autoriteti juaj kontraktor ka përllogaritur fondin limit të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me REF -41187-03-15-2025, me objekt: “Supervizion punimesh per objektin: “Ndërtimi i Ujësjiellësave për fshatrat Fushëbardhe - Zhulat, Bashkia Gjirokastër”.

II.10. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse me nr. 1151/15 prot, datë 17.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1042/4 prot., datë 22.05.2025, me objekt: “*Dërgim informacioni*”, është përcjellë nga autoriteti kontraktor informacioni i kërkuar.

II.11. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, vendos të thërrasë ekspertin e fushës për të verifikuar nëse përllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

II.12. Eksperti zgjidhet nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar në përputhje me nenin 24 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

II.13. Eksperti i parë në rend alfabetik i cili referuar dokumentacionit zotëronte kualifikimet e kërkuara për kryerjen e ekspertizës është Ekspertia Znj.Arta Tani, e cila do të asistojë, Komisionin e Prokurimit Publik, në zgjidhjen e çështjes objekt-ankimi. Në datën 09.05.2025

u komunikua me telefon, nga telefoni i zyrës së protokollit, me ekspertin Znj.Arta Tani. Ekspertia pranon, se është e specializuar për përllogaritjen e kostove për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim dhe përcaktoi tarifën prej 100,000 lekë për kryerjen e ekspertizës. Pas paraqitjes së saj, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u dakortësua asistenca e saj, në zgjidhjen e çështjes objekt-ankimi sipas procesverbalit të datës 12.05.2025. Gjithashtu, Ekspertia pranon se për kryerjen e ekspertizës i nevojiten 7 ditë kohë nga marrja e dokumentacionit.

II.14. Me Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 689/2025 datë 22.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të urdhërojë kryerjen e Ekspertimit të Posaçëm lidhur me përllogaritjen në vlerën minimale dhe maksimale të fondit limit, nga eksperti i përzgjedhur nga lista e ekspertëve vjetorë të miratuar për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Shërbime” me nr. REF -41187-03-15-2025, me objekt: “Supervizion punimesh per objektin: “Ndërtimi i Ujësjellësave për fshatrat Fushëbardhe - Zhulat, Bashkia Gjirokastër”, me fond limit 3,332,777 (tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.A.*
2. *Operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK të parapaguajë për llogari të Ekspertes znj. A. T., shumën prej 100,000 lekë si tarifë e përcaktuar për kryerjen e ekspertimit dhe të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda datës 26.05.2025 ora 11:00.*
3. *Autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik ankimues “G B Civil Engineering” SHPK të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim mbi çështjet që duhet të trajtohen nga Eksperti brenda datës 26.05.2025.*
4. *Në datën 27.05.2025 ora 11:00 të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik Ekspertia znj. A. T., për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e ekspertizës.*
5. *Eksperti ngarkohet të kryejë aktin e ekspertimit dhe të dorëzojë materialin në formë shkresore. Akti i ekspertimit të dorëzohet jo më vonë se data 03.06.2025.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.14.1.Me shkresën përcjellëse me objekt “Dërgim vendimi” me nr. 1042/7 prot., datë 22.05.2025 Komisioni i Prokurimit Publik, iu dërgua me shërbim postar Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 689/2025 datë 22.05.2025 për OE “G B Civil Engineering Sh.p.k.

II.15. Me shkresën e datës 25.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1042/8 prot., datë 26.05.2025, nëpërmjet shërbimit postar, operatori ekonomik ankimues ka depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik formularin e ankesës, argumentim si dhe mandat - pagesën, e cila vërteton kryerjen e pagesës në llogarinë e ekspertes Znj.A.T, në zbatim të vendimit nr. 689/2025, datë 22.05.2025 të KPP-së. Ndërsa, nga ana e autoritetit kontraktor nuk u paraqit

brenda datës 26.05.2025, asnjë përfaqësues për pretendime me shkrim, mbi çështjet që duhet të trajtoheshin nga Eksperti.

II.16. Me shkresën nr. 1042/9 prot., datë 26.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik i ka dërguar ekspertës Znj.A.T, pyetjet që shtrohen për zgjidhje nga ana e saj, lidhur me procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht ekspertës i janë parashtruar këto pyetje:

1. *A është përlllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"?*
2. *Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit "Ndërtimi i Ujësjiellësave për fshatrat Fushëbardhe - Zhulat, Bashkia Gjirokastër" me fond limit 248,188,809.90 lekë (pa tvsh), lekë pa tvsh, referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" ?*

Vlerat e llogaritura për kufijte minimalë dhe maksimalë të shërbimit të supervizimit të jepen me dy shifra pas presjes.

II.17. Në zbatim të vendimit nr. 689/2025, datë 22.05.2025 të KPP-së, me dokumentin e datës 28.05.2024, me objekt "Raport ekspertimi" protokolluar me tonën me nr.1042/10 prot., datë 28.05.2024, ekspertia ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, raportin e nënshkruar lidhur me procedurën objekt - ankimi, në të cilën ndër të tjera citohet si më poshtë vijon:

" [...] Në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.05.2016 dhe në bazë të llogaritjes sipas përqindjeve progresive për vlerat ndërmjetëse, vlera minimale e supervizimit teknik për objektin me vlerë ndërtimi 248188810 lekë pa tvsh është:

2.885.893.67 (dy million e teteqind e tetedhjetë e pesë mijë e teteqind e nëntëdhjetë e tre pike gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH.

Vlera limit e supervizimit 3.308.174.26 (tre million e treqind e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër presje njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të përlllogaritjes së mësipërme Autoriteti kontraktor ka devijim të llogaritjes si nga vlera limit e supervizimit ashtu dhe për llogaritjen e vlerës minimum të supervizimit. Si metodë llogaritje është bazuar sipas legjislacionit në fuqi dhe ndryshimi është për efekt të devijimeve të vogla në llogaritje. Në VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", nuk përcaktohet një numër i saktë shifrash pas presjes dhjetore për llogaritjen e koeficientëve të projektimit. Ky manual ka si qëllim standardizimin e tarifave për shërbimet e ofruara në fushat e planifikimit të territorit dhe projektimit, por nuk specifikon formatin e saktë të numrave të përdorur në llogaritje. Për të siguruar një praktikë të qëndrueshme dhe të qartë në llogaritjen e këtyre koeficientëve, është e rekomandueshme të përdoren deri në dy shifra pas presjes dhjetore. Ky format është i zakonshëm në fushat e inxhinierisë dhe ndihmon në ruajtjen e saktësisë dhe transparencës në llogaritje.

Rekomandohet që në të ardhmen, për qëllime unifikimi dhe shmangie të interpretimeve të ndryshme, të shqyrtohet mundësia e një orientimi nga autoriteti kontraktor mbi saktësinë numerike pas presjes dhjetore në aplikimin e koeficientëve të projektimit.

II.19. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, i ndryshuar, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “G B Civil Engineering” SHPK mbi skualifikimin e tij nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave me argumentimin se: *“OE ka ofertuar me pak se vlera minimale e mbikqyrjes se objektit e cila eshte llogaritur mbeshetur ne VKM –ne , nr.354, date 11.05.2016 “Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik, për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me vendimin e ndërmjetëm nr. 689/2025 datë 22.05.2025, vendosi të thërrasë ekspertin e fushës, për të verifikuar nëse përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354 datë 11.05.2016, *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”*.

III.1.2. Me shkresën nr. 1042/9 prot., datë 26.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik i ka dërguar ekspertës Znj.A.T, pyetjet që shtrohen për zgjidhje nga ana e saj, lidhur me procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht ekspertës i janë parashtruar këto pyetje:

- 1. A është përlllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”?*
- 2. Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Ndërtimi i Ujësjellësave për fshatrat Fushëbardhe - Zhulat, Bashkia Gjirokastrë” me fond limit 248,188,809.90 lekë (pa tvsh), lekë pa tvsh,referuar VKM*

nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” ?

Vlerat e llogaritura për kufijte minimalë dhe maksimalë të shërbimit të supërvizimit të jepen me dy shifra pas presjes.

III.1.3. Në zbatim të vendimit nr. 689/2025, datë 22.05.2025 të KPP-së, me dokumentin e datës 28.05.2024, me objekt “Raport ekspertimi” protokolluar me tonën me nr.1042/10 prot., datë 28.05.2024, ekspertia ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, raportin e nënshkruar lidhur me procedurën objekt - ankimi.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.5. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Komisioni konstaton, se pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues "G B Civil Engineering" SHPK kanë të bëjnë përkatësisht me vlerën minimale të lejuar, të përlllogaritur nga ankimuesi bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*", grupit tarifar III, Vepra inxhinierike dhe të argumentuara me analizën sipas përlllogaritjeve kërkon rivlerësim të ofertave dhe vlefshmërinë e ofertës së tij.

Për një shqyrtim sa më të drejtë dhe transparent të pretendimeve të palës ankimuese, KPP gjykoi të nevojshme, të thërrasë ekspertin e fushës, për të verifikuar nëse përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt – ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354 datë 11.05.2016, "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*", si dhe të përlllogarisë kufirin minimal dhe maksimal të shërbimit të supervizimit, për procedurën e prokurimit "Ndërtimi i Ujësjellësave për fshatrat Fushëbardhe -Zhulat, Bashkia Gjirrokastër", me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSh, referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*". Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016 "*Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*", si dhe manuali përkatës, i cili përcakton nivelin në përqindje të tarifave për shërbimet e mbikëqyrjes, në varësi të vlerës së ndërtimit të objektit. Në VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016, "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe*

kolaudim", nuk përcaktohet një numër i saktë shifrash pas presjes dhjetore për llogaritjen e koeficientëve të projektimit. Ky manual ka si qëllim standardizimin e tarifave për shërbimet e ofruara në fushat e planifikimit të territorit dhe projektimit, por nuk specifikon formatin e saktë të numrave të përdorur në llogaritje.

Referur dokumentacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor me shkresën përcjellëse me nr. 1151/15 prot, datë 17.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1042/4 prot., datë 22.05.2025, ku autoriteti kontraktor ka dhënë informacion të detajuar mbi procesverbalin e përllogaritjes së fondit limit të projektit të zbatimit me objekt “ Ndërtimi i Ujësjiellësave për fshatrat Fushëbardhe - Zhulat, Bashkia Gjirokastër ”, referuar të cilit autoriteti kontraktor ka përllogaritur fondin limit të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me REF -41187-03-15-2025, me objekt: “Supervizion punimesh per objektin: “Ndërtimi i Ujësjiellësave për fshatrat Fushëbardhe - Zhulat, Bashkia Gjirokastër”.

Nga ky dokument rezulton se:

“[...] Në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.05.2016 dhe në bazë të llogaritjes sipas përqindjeve progresive për vlerat ndërmjetëse, vlera minimale e supervizimit teknik për objektin me vlerë ndërtimi 248,188,809.90 lekë pa tvsh është:

2,905,749 (dy million e nëntëqind e pesë mijë e shtatëqind e dyzetë e nëntë) lekë, pa TVSH.

Vlera limit e supervizimit 3,332,777 (tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Ndërsa, referuar “Raport ekspertizës” së ekspertës Znj.A.T, me shkresën e datës 28.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1042/10 prot., datë 28.05.2025, ka rezultuar se :

“ [...] Në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.05.2016 dhe në bazë të llogaritjes sipas përqindjeve progresive për vlerat ndërmjetëse, vlera minimale e supervizimit teknik për objektin me vlerë ndërtimi 248,188,809.90 lekë pa tvsh është:

2.885.893.67 (dy million e teteqind e tetedhjetë e pesë mijë e teteqind e nëntëdhjetë e tre pike gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH.

Vlera limit e supervizimit 3.308.174.26 (tre million e treqind e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër presje njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të përllogaritjes së mësipërme Autoriteti kontraktor ka devijim të llogaritjes si nga vlera limit e supervizimit ashtu dhe për llogaritjen e vlerës minimum të supervizimit. Si metodë llogaritje është bazuar sipas legjislacionit në fuqi dhe ndryshimi është për efekt të devijimeve të vogla në llogaritje. Në VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", nuk përcaktohet një numër i saktë shifrash pas presjes dhjetore për llogaritjen e koeficientëve të projektimit. Ky manual ka si qëllim standardizimin e tarifave për shërbimet e ofruara në fushat e planifikimit të territorit dhe projektimit, por nuk specifikon formatin e saktë të numrave të përdorur në llogaritje. Për të siguruar një praktikë të qëndrueshme dhe të qartë në llogaritjen e këtyre koeficientëve, është e rekomandueshme të përdoren deri në dy shifra pas presjes dhjetore. Ky format është i zakonshëm në fushat e inxhinierisë dhe ndihmon në ruajtjen e saktësisë dhe transparencës në llogaritje.

Rekomandohet që në të ardhmen, për qëllime unifikimi dhe shmangie të interpretimeve të ndryshme, të shqyrtohet mundësia e një orientimi nga autoriteti kontraktor mbi saktësinë numerike pas presjes dhjetore në aplikimin e koeficientëve të projektimit.

Operatori ekonomik ankimues në shkresën e datës 25.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1042/8 prot., datë 26.05.2025, nëpërmjet shërbimit postar, ka depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik formularin e ankesës, argumentim si dhe mandat – pagesën për ekspertin. Referuar formularit të ankesës si edhe të informacionit të dërguar nga subjekti ankimues, Komisioni evidentoi se edhe nga përllogaritjet e vet operatorit ekonomik ankimues në formular ankese të paraqitur ashtu edhe në informacionin shtesë me argumenta të datë 26.05.2025 ka cituar se: *vlera minimale e supervizimit teknik për objektin me vlerë ndërtimi 248,188,809.90 lekë pa tvsh është:*

2.885.893.67 (dy million e teteqind e tetedhjetë e pesë mijë e teteqind e nëntëdhjetë e tre pike gjatëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH.

Nga shqyrtimi i gjithë dokumentacionit të cituar më sipër, referuar edhe provave të depozituara nga palët e interesuara në këtë proces shqyrtimi, KPP konstaton, se operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK, ka paraqitur në SPE Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, ku ka deklaruar se çmimi i ofertës pa TVSH është **2,878,990.19** lekë pa tvsh (vlerë minimale), vlerë e cila nuk është sa minimumi i lejuar për shërbimin e supervizimit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, referuar “Raport ekspertizës” së ekspertes Znj. A. T, raport i cili është hartuar referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Gjithashtu, vlera e ofertës së subjektit ankimues nuk është sa minimumi i lejuar për shërbimin e supervizimit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi referuar përllogaritjeve të bëra nga ana e autoritetit kontraktor, për më tepër as të vetë përllogaritjeve të kryera nga vetë subjekti ankimues si palë e interesuar.

Sa më sipër konstatuar, Komisioni vlerëson, se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK në vlerën **2,878,990.19** lekë pa TVSh, nuk është e rregullt, pasi është më poshtë se vlera e lejuar për shërbimin e supervizimit për procedurën e prokurimit objekt – ankimi referuar raportit të ekspertit, e për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “G B Civil Engineering” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Shërbime” me nr. REF -41187-03-15-2025, me objekt: “Supervizion punimesh per objektin: “Ndërtimi i Ujësjellësve për fshatrat Fushëbardhe - Zhulat, Bashkia Gjirokastër”, me fond limit 3,332,777 (tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e shtateqind e shtatedhjetë e shtate) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.A.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

